



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES
V E N D I M

Nr.12, datë 31.08.2021

Për

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: MBI DISA SHTESA E
NDRYSHIME TË ANEKSIT 1 TË RREGULLORES NR.12, DATË 07.04.2010 “PËR TË
DHËNAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE PERIODIKE TË SIPËRMARRËSVE
TË RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE” TË
NDRYSHUAR**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 31.08.2021 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të DTMRR dhe Grupit të Punës, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar.

BAZA LIGJORE:

1. Gërma p) dhe nj) e nenit 8, neni 16, 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);

2. Rregullore nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar;
3. Udhëzues për Procedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: *Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar;*
- Relacioni shoqërues i projekt aktit (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Rregullorja nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, është miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP me qëllim përcaktimin e rregullave për evidentimin dhe raportimin e të dhënave statistikore dhe financiare periodike të tregut të komunikimeve elektronike. Ndryshimet e miratuara të rregullores ndër vite, kanë përfshirë ndryshime të rëndësishme duke saktësuar përkufizimet, shtuar treguesit për aksesin broadband, treguesit për të ardhurat si dhe kanë saktësuar afatet e raportimit.
2. Duke marr në konsideratë:
 - dinamikën e sektorit, shërbimet e reja të hyra në treg dhe treguesit që AKEP duhet të analizojë dhe raportojë edhe në organizmat ndërkombëtare (përfshirë këtu edhe detyrimin për raportimin pranë RCC të të dhënave statistikore dhe financiare për zbatimin e Marrëveshjes së Roaming Rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndryshime të realizuara pas amendimit të ligjit 9918/2008 i ndryshuar);
 - ndryshimet dhe saktësimet e treguesve statistikorë të të dhënave të kryera nga ITU, gjatë viteve të fundit (të dhënat për treguesit statistikor të parashikuara në rregulloren nr.12, datë 07.04.2010, të ndryshuar, janë hartuar mbi metodologjinë dhe terminologjinë e përdorur nga ITU);
 - indikatorët e rinj të vendosur nga ITU në pyetësorët e viteve të fundit për të cilët do të kërkohej informacion nga autoritetet rregullatore gjatë periudhave të ardhshme të raportimeve;
 - zhvillimet pozitive në përdorimin e modulit online të AKEP (RevZone) si lehtësi për raportimin e të dhënave nga operatorët.

AKEP gjykon të nevojshme amendimin e formularëve dhe shtimin e treguesve dhe të dhënave statistikore që sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve

elektronike duhet të raportojnë në AKEP sipas rregullores Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar.

3. Dokumenti për disa shtesa e ndryshime në aneksin 1 të rregullores është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, si edhe merr në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe ITU me synim përcaktimin e rregullave për evidentimin e të dhënave statistikore dhe financiare periodike në tregun e komunikimeve elektronike, në funksion të përmirësimit të treguesve të raportuar për monitorimin dhe analizimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi nga ana e AKEP.

Ky dokument:

- a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator i cili shërben për përgatitjen e të dhënave dhe serive kohore për kryerjen e analizave sipas tregjeve përkatëse, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
- b. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918/2008.

Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës çmon të arsyeshme nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit: *Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”* e ndryshuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu edhe për sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, bazuar në gjurmën p) të nenit 8, neni 31, 32, 33, 34, 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”*” e ndryshuar sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të*

sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar të publikohen në faqen e internetit akep.al.

4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako	Xhoana Lilaj



**MBI DISA SHITESA E NDRYSHIME TË
ANEKSIT 1 TË RREGULLORES NR.12,
DATË 07.04.2010**

**“PËR TË DHËNAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE PERIODIKE TË
SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE”**

Dokument për Këshillim Publik

(MIRATUAR ME VKD NR.12 DATË 31.08.2021)

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të dhënave periodike për shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike të ofruara nga sipërmarrësit e pajisur me autorizim të përgjithshëm nga AKEP, detyrimet dhe rregullat për sipërmarrësit për depozitimin informacioni.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore dhe të dhënat e kërkuara nëpërmjet kësaj rregulloreje janë hartuar në zbatim të kompetencave të AKEP të përcaktuara në Nenin 8 (gërma o, gërma p), dhe detyrimit të sipërmarrësve për të dërguar informacion në AKEP sipas Nenit 16 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Detyrimet e sipërmarrësve për dërgimin e të dhënave

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjithë sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të cilët bëjnë pjesë në regjistrin e sipërmarrësve të publikuar në faqen zyrtare të AKEP.
2. Çdo sipërmarrës ka detyrimin që të plotësojë Formularët e listuar në nenin 4 (në vijim), duke dërguar formularet dhe informacionin e kërkuar sipas procedurave dhe afateve të kësaj rregulloreje.
3. Çdo sipërmarrës zbaton detyrimin e cituar në pikën 2 të këtij neni, si dhe detyrimet e tjera në këtë rregullore.

Neni 4

Formularët dhe të dhënat e kërkuara nga AKEP

1. Informacioni dhe të dhënat që duhet të dërgojnë sipërmarrësit e autorizuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike përcaktohen nga AKEP nëpërmjet formularëve dhe sipërmarrësi do të shkarkojë formularet nga moduli on-line në çdo fazë për të cilën është detyrim ligjor plotësimi i tyre.
2. Formularët përfshijnë:
 - a. Të dhëna dhe tregues vjetore të ofrimit të shërbimeve dhe rrjeteve publike të komunikimeve elektronike:
 - i. **Formulari A:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të telefonisë fikse;
 - ii. **Formulari B:** Ofrimi i shërbimeve të Internetit;

- iii. **Formulari C:** Tregues vjetore të ofrimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve të rrjetit fiks;
 - iv. **Formulari D:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të telefonisë së lëvizshme;
 - v. **Formulari E:** Të dhëna vjetore financiare.
- b. Të dhëna dhe tregues tre-mujore të ofrimit të shërbimeve dhe rrjeteve publike të komunikimeve elektronike
 - i. **Formulari G:** Të dhëna tre mujore për shërbime dhe rrjete fikse
 - ii. **Formulari H:** Të dhëna tre-mujore për shërbime dhe rrjete celulare
3. Formularët me treguesit përkatës dhe shpjegimet e nevojshme janë pjesë e kësaj rregulloreje (Aneks 1) dhe publikohen nga AKEP **në modulën përkatës on-line të AKEP për këtë qëllim.** Drejtoria përkatëse e AKEP përgjegjëse për statistikën mund të kryejë saktësime të përkufizimeve dhe sqarimeve të treguesve të formularëve për përmirësimin e tyre.
4. AKEP mund të kërkojë të dhëna shtesë, jo të specifikuar në formularë, nëpërmjet njoftimeve në formë shkresore dhe/ose në rrugë elektronike, në të cilat përcaktohet lloji, afatet për dërgimin e të dhënave si dhe qëllimi i kërkesës.

Neni 5

Afatet e plotësimit të formularëve dhe mënyra e raportimit

1. Informacioni dhe të dhënat e kërkuara sipas **Formularëve G dhe H,** raportohen on-line nga sipërmarrësi çdo 3 muaj:
 - a. Brënda datës **30 Prill** të çdo viti: të dhënat e Tremujorit të I-rë Janar-Mars (TQ1) të vitit kalendarik korrent;
 - b. Brënda datës **30 Korrik** të çdo viti: të dhënat e Tremujorit të II-të Prill-Qershor (T2) të vitit kalendarik korrent;
 - c. Brënda datës **30 Tetor** të çdo viti: të dhënat e Tremujorit të III-të Korrik-Shtator (T3) të vitit kalendarik korrent;
 - d. Brënda datës **30 Janar** të çdo viti: të dhënat e Tremujorit të IV-të Tetor-Dhjetor (T4) të vitit kalendarik paraardhës;
2. Informacioni dhe të dhënat vjetore të kërkuara sipas **Formularëve A, B, C dhe D raportohen on-line** nga sipërmarrësi çdo vit brënda datës **30 Janar** të vitit kalendarik pasardhës.
3. Informacioni dhe të dhënat financiare të kërkuara sipas Formularit E raportohen on-line nga sipërmarrësi çdo vit brënda datës **10 Prill** të vitit kalendarik pasardhës.
4. **Sipërmarrësi ka detyrimin që për çdo periudhë raportimi të plotësojë formularët përkatës dhe raportojë të dhënat në AKEP sipas afateve, udhëzimeve dhe përkufizimeve**

në këtë rregullore dhe aneksin e saj, si dhe udhëzimeve për përdorimin e modulit on-line përkatës të AKEP për këtë qëllim.

Neni 6

Cilësia e të dhënave

Sipërmarrësi duhet të garantojë plotësimin e të gjithë treguesve të kërkuar dhe të dhënat e raportuara duhet të jenë të krahasueshme me periudha të mëparshme raportimi. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë integritetin e të dhënave përgjatë periudhave kohore të raportuara duke mbajtur një gjurmë të përshtatshme auditimi të mundshëm nga AKEP për të gjithë informacionin e raportuar, duke garantuar midis të tjerave:

1. Plotësinë e informacionit
Sipërmarrësi duhet të raportojë të gjitha të dhënat e kërkuara në formularë të cilat janë të aplikueshme për aktivitetin e tij.
2. Krahasueshmërinë e informacionit
Sipërmarrësit duhet të raportojnë të dhënat duke iu referuar përkrahimeve të dhëna nga AKEP dhe njëkohësisht treguesit e raportuar duhet të jenë të krahasueshëm në periudha të ndryshme. Në rast të ndryshimit të mënyrës së matjes së një treguesi nga sipërmarrësi, ai duhet të vendosë sqarimin përkatës, arsyen dhe vlerat e treguesit për periudhat e mëparshme të raportuara sipas mënyrës së re të matjes.
3. Ruajtja e të dhënave
Të gjitha informacionet e raportuara në AKEP duhet të ruhen nga sipërmarrësi, duke krijuar mundësinë për të provuar vërtetësinë e treguesve të raportuar dhe mënyrës së matjes së tyre, në rast verifikimi të tyre nga AKEP. Afati për ruajtjen të dhënave të raportuara dhe provat e matjes së tyre është 3 vjet.

Neni 7

Verifikimi nga AKEP i të dhënave

Nëse të dhënat e dërguara nga sipërmarrësi nuk janë në standartin e të dhënave të kërkuara nga AKEP dhe krijojnë dyshime mbi saktësinë e tyre:

1. AKEP mund të kërkojë sqarime sipërmarrësit apo Personit të kontaktit nëpërmjet të gjithave mënyrave të komunikimit si: duke përdorur modulin on-line, me shkresë, me telefon dhe/ose me e-mail.
2. Sipërmarrësi/Personi i kontaktit duhet të japë sqarime dhe informacionin e saktë që plotëson kriteret e përcaktuara në formularët e të dhënave, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës së AKEP për sqarime të cituar në pikën „a“.

3. AKEP mund të kryejë verifikime të saktësisë së të dhënave të depozituara nga sipërmarrësi, nëpërmjet inspektimit në ambientet/dokumentacionin e sipërmarrësit.

Neni 8

Përdorimi i të dhënave nga AKEP

1. AKEP, nëpërmjet Njesisë përgjegjëse për Statistikat, do të bëjë përpunimin e informacionit periodik të depozituar nga sipërmarrësi, informacioni i cili do të shërbejë si element bazë për:
 - a) Monitorimin e vazhdueshëm të tendencave të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri për plotësimin e objektivave rregullatore të AKEP si dhe politikës sektoriale;
 - b) Zhvillimin e analizave të tregut nga AKEP;
 - c) Informacion për publikim për publikun e gjërë nëpërmjet raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut:
 - i. Të dhënat tre-mujore publikohen nga AKEP **brënda 30 ditëve nga afati i depozitimit të të dhënave nga sipërmarrësit, përveç rasteve kur është e nevojshme saktësimi i tyre nga sipërmarrësit;**
 - ii. Të dhënat vjetore publikohen nga AKEP brënda muajit Maj të vitit pas-ardhës.
 - d) Plotësimin e kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombetare që monitorojnë zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri;
2. AKEP zbaton parimet e konfidencialitetit në publikimin dhe përdorimin e të dhënave të tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 9

Sanksionet

Mos-dërgimi i Formularëve të plotësuar sipas afateve dhe kërkesave të AKEP të përcaktuara në këtë rregullore, përbën shkelje të nenit 16 të ligjit nr.9918, i ndryshuar dhe kundërvajtje administrative e sanksionuar sipas nenit 137.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, pas miratimit në KD

Aneks 1: Formularët e të dhënave të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike publike

Ndryshimet në Formularët e treguesve statistikore/financiare, janë theksuar me **ngjyre të kafe të hapur** në skedarin në format Excel, bashkangjitur.